



**UNIVERSITETI “KADRI ZEKU” UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel: 0280390112**

---

## **POLITIKA E PRIVATËSISË**

### **Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan**

#### **1. E drejta e privatësisë**

Mbrojtja e të dhënave personale është prioritet për Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, i cili angazhohet t’i përpunojë këto të dhëna me transparencë, drejtësi dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>) dhe me rregulloren përkatëse të BE-së (GDPR), aty ku është e zbatueshme (<https://gdpr.eu/ehat-is-gdpr/>).

Kjo politikë aplikohet për të gjithë personat fizikë që janë në marrëdhënie me UKZ-në, përfshirë studentët, stafin akademik dhe administrative dhe palët tjera të interesit, palët kontraktuese dhe aplikantët për punë, etj.

#### **2. Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, si institucion publik i arsimit të lartë, përpunon të dhëna personale të studentëve, stafit akademik, stafit administrativ, bashkëpunëtorëve dhe palëve të tjera të lidhura me aktivitetet e tij ligjore, akademike, kërkimore dhe administrative. Përpunimi i këtyre të dhënave bëhet vetëm për qëllime të caktuara dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë.

Të gjitha njësitë akademike dhe njësitë administrative (zyrat dhe divizionet përkatëse) të UKZ-së përpunojnë të dhëna personale në formën dhe masën që kërkohet nga funksionet dhe detyrat e tyre (për shembull: regjistrimi i studentëve, administrimi i stafit, proceset financiare, menaxhimi i cilësisë, aktivitetet kërkimore, etj.).

Përgjegjësia për përpunimin e të dhënave personale i takon Universitetit Publik “Kadri Zeka” në tërësi, përfshirë menaxhmentin e lartë, udhëheqësit e njësive akademike dhe administrative, si dhe zyrtarin e caktuar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

dhe raportimin në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky zyrtar ka detyrë shtesë që të monitorojë zbatimin e politikave të privatësisë, të sigurojë respektimin e legjislacionit në fuqi dhe të raportojë çdo incident të mundshëm lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

### **3. Kategoria e të dhënave personale që përpunohet**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” përpunon një gamë të gjerë të dhënave personale të individëve që janë në marrëdhënie me institucionin, përfshirë studentët, stafin akademik e administrativ, bashkëpunëtorët, vizitorët dhe palët e treta. Këto të dhëna përpunohen për qëllime të caktuara që lidhen me çështjet studentore, ligjore, akademike, administrative, kontraktuale dhe kërkimore/ hulumtuese të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Këto janë kategoritë të dhënave që UKZ përpunon:

- Të dhëna të identifikimit (emër, mbiemër, nr. personal, ID studentore);
- Të dhëna të kontaktit (email, adresë, telefon);
- Të dhëna për arsimimin, kualifikimet dhe historikun profesional;
- Të dhëna për shëndetin (nëse kërkohen në bazë të ligjit);
- Të dhëna të kërkuara për marrëdhënie kontraktuale ose ligjore;
- Regjistrime video nga kamerat e sigurisë ose ngjarje publike;
- Të dhëna të tjera të kërkuara për ofrimin e shërbimeve ligjore dhe akademike.

### **4. Qëllimet e përpunimit të dhënave personale**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” përpunon të dhënat personale vetëm për qëllime të përcaktuara, legjitime dhe të nevojshme për realizimin e funksioneve të tij si institucion publik i arsimit të lartë. Qëllimet e përpunimit përfshijnë, ndër të tjera, menaxhimin e marrëdhënieve të punës, sigurimin e cilësisë, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe zhvillimin e aktiviteteve kërkimore e bashkëpunimeve ndër-institucionale. Ndër të gjitha që u thanë, ju japim më poshtë qëllimet e renduara:

- Zbatimi i detyrimeve ligjore dhe administrative;
- Menaxhimi i marrëdhënieve të punës dhe përzgjedhja e stafit;
- Menaxhimi i të dhënave me studentët (pranim, regjistrim, notim, diplomim);
- Përpunimi i pagesave, bursave, kontratave dhe aktiviteteve financiare;
- Menaxhimi i trajnimeve, konferencave dhe promovimeve akademike;
- Monitorimi i sigurisë fizike në hapësirat e UKZ-së;
- Menaxhimi i komunikimit dhe shërbimeve online;
- Përgjigjja ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike;
- Promovimi i aktiviteteve përmes publikimeve në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale.

### **5. Baza ligjore për përpunim**

Përpunimi i të dhënave personale nga Universiteti Publik “Kadri Zeka” bazohet në legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës, përfshirë Ligjin Nr. 06/L-082 për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në aktet nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë, marrëdhëniet e punës dhe funksionimin e institucioneve publike. Përpunimi bëhet vetëm nëse ekziston një bazë ligjore e qartë, si p.sh. një detyrim ligjor, një marrëveshje kontraktuale, ushtrimi i një funksioni zyrtar apo dhënia e pëlqimit nga subjekti i të dhënave. Kjo është baza ligjore, që UKZ mbështetet lidhur me përpunimin e të dhënave personale:

- Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji për Arsimin e Lartë;
- Ligji për Zyrtarët Publikë dhe Ligji i Punës;
- Ligji për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji për Arkivat Shtetërore;
- Statuti I UKZ-së
- Rregulloret e brendshme të UKZ-së

## **6. Me kë i ndajmë të dhënat tua personale?**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” përpunon dhe ruan të dhënat personale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për nevoja të brendshme institucionale. Kur është e nevojshme dhe e lejuar me ligj, këto të dhëna mund të ndahen me palë të treta, duke përfshirë autoritetet shtetërore, gjyqësore dhe mbikëqyrëse, Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ministritë përkatëse, komunën, partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve ndërkombëtare që UKZ ka, marrëveshjet bilaterale me universitete tjera, si dhe institucione apo organe të tjera publike dhe kontraktuese që bashkëpunojnë me universitetin. Kjo ndarje realizohet vetëm për qëllime të ligjshme, si për përmbushjen e detyrimeve ligjore, financiare, akreditimit, raportimit, auditimit apo kontrollit institucional, duke siguruar gjithmonë mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të dhënave personale.

## **7. Cilat janë të drejtat tua?**

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë një sërë të drejtash të garantuara me ligj, të cilat sigurojnë kontroll mbi përpunimin e të dhënave personale. Këto të drejta përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, të drejtën për qasje, korrigjim, fshirje, kufizim të përpunimit, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin dhe të drejtën për të paraqitur ankesë pranë autoriteteve kompetente për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të drejta përfshijnë:

- Qasja në të dhënat tua personale;
- Të kërkon korrigjimin ose përditësimin e tyre;
- Të kërkon fshirjen nëse përpunimi nuk ka më bazë ligjore;
- Të kërkon ndalimin apo kufizimin e përpunimit;
- Të kërkon njoftimin e palëve të treta për ndryshimet;
- Të paraqisni ankesë nëse mendohet se janë shkelur të drejtat tua.

## **8. E drejta e ankimimit**

E drejta e ankimimi është e drejtë e garantuar mëe Lligj. Palët kanë të drejtë që, në rast se besojnë se të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale janë shkelur gjatë përpunimit nga Universiteti Publik “Kadri Zeka”, të paraqesin ankesë pranë Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në UKZ. Përveç kësaj, çdo palë ka të drejtë të ankohet pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës, e cila është autoriteti kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale në nivel shtetëror.

## **8. E drejta e ankimimit**

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë në Universitetin Publik “Kadri Zeka”, Adresa: rr. Zijah Shemsiu, p.n. 60000 Gjilan, me nr kontaktues: +383280390112 ose në e-mail adresën [info@uni-gjilan.net](mailto:info@uni-gjilan.net) ([www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)). Gjithashtu pranë Agjencisë për informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. (Web [www.aip.rks-gov.net](http://www.aip.rks-gov.net)).

## **9. Siguria dhe ruajtja e të dhënave personale**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” zbaton masa të avancuara fizike, teknike dhe organizative për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale nga qasjet e paautorizuara, humbja, modifikimi apo shpërndarja e tyre e paligjshme. Këto masa përfshijnë përdorimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, sisteme anti-virus, enkriptim të dhënave, kontrole të aksesit, si dhe monitorim të vazhdueshëm të sistemeve dhe rrjeteve të informacionit. Përveç kësaj, UKZ trajnon stafin në lidhje me praktikat më të mira për mbrojtjen e të dhënave dhe arkivimit të dhënave sipas legjislacionit në fuqi.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave varet nga qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe është e përcaktuar sipas ligjeve përkatëse, duke siguruar që ato të mos ruhen më gjatë se sa është e nevojshme.

## **10. Përditësimi i Politikës së Privatësisë**

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka angazhim të vazhdueshëm për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të përmbushur standardet më të larta të privatësisë. Prandaj, politika e privatësisë mund të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë periodike të vazhdueshme për t’u përshtatur me ndryshimet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, teknologjitë e reja të përpunimit, praktikave institucionale dhe nevojave të funksionimit të universitetit.

Çdo ndryshim apo përditësim i politikës do të bëhet i disponueshëm në mënyrë transparente në faqen zyrtare të universitetit dhe palët e interesuara do të njoftohen në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me dispozitat ligjore dhe me procedurat e brendshme të komunikimit.

Ky proces garanton që të dhënat personale të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente gjatë gjithë kohës, duke mbrojtur në mënyrë efikase privatësinë dhe të drejtat e palëve.

**Gjilan, Gusht 2025**